



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:222307

Datë: 20.03.2025

Numri i dokumentit: 07019308

**Ac.nr.3569/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Bujar Dobërdolani- anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.K. nga L., të cilin me autorizim e përfaqëson Nazmije Aliu av. në Lipjan, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit të cilën e përfaqëson Fatime Mustafa me autorizim, për shkak të kompensimit të pagës jubilarë, si dhe kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, udhëtimit dhe ndryshimin e pagës në bazë të kualifikimit-licencës, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.493/19 të datës 23.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më **20.03.2025**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET SI E PA THEMELTË** ankesa e të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa Aktgjykimi i të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.493/19 të datës 23.11.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.493/19, të datës 23.11.2021 në pikën I., të dispozitivit ka aprovuar në tërësi sit ë bazuar kërkesëpadinë e precizuar e paditësit I.K. nga L.. Në pikën II., të dispozitivit ka obliguar të paditurën Komuna e Lipjanit-Drejtoria e Arsimit, që paditësit t'i paguajë dhe atë: në emër të shpërblimit jubilar shumën prej 318.94-€, si dhe kamatën në shumën prej 100.44-€ që në total janë 419.38-€, në emër të ushqimit për kohën që paditësi ka punuar 1,846.00-€, si dhe kamatën 332.04-€, në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit prej 70% të biletës shumën prej 559.38-€, si dhe kamatën 100,17-€ që në total kapin shumën 659,55-€, në emër të ndryshimit për kompensimin për kualifikim-licencë shumën prej 2,145.42-€, me kontributet pensionale shumën prej 107.65-€ për punëmarrësin, kontributin pensional shumën prej 107.65-€ për punëdhënësin, kamatën në shumë prej 304.83-€, të gjitha shumat e cekura më lartë të llogariten me kamatë në shkallë prej 8% që nga data e marrjes së këtij aktvendimi e deri në pagesën definitive, në afatin prej 15 ditëve nga dita e

plotëfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbartimit me dhunë. Në pikën III., të dispozitivit detyrohet e paditura që paditëseve t'ia kompenzoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 713-€ në afat prej 7 ditësh nga plotëfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të paraparë ligjor, ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që gjykata ta aprovojë si të bazuar ankesën dhe çështjen ta kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Paditësja ka parashtruar përgjigje në ankesë me propozim që Aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 195 dhe 200 të LPK-së, gjeti se:

#### **Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se, paditësi I.K., përmes përfaqësuesit të autorizuar, Nazmije Aliu, avokate nga Lipjani, me datë 04.10.2019, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit për shkak të kompensimit të pagës jubilarë, kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të udhëtimit si dhe kompenzimin sipas ndryshimit në bazë të kualifikimit-licencës, ndërsa me parashtrësën e datës 16.11.2021 ka bërë precizimin e kërkesëpadisë ç'rast ka kërkuar që të obligohet e paditura që paditësit t'ia kompenzoj: në emër të shpërblimit jubilar shumë prej 318.94-€, si dhe kamatën në shumë prej 100.44-€ që në total janë 419.38-€, në emër të ushqimit për kohën që paditësi ka punuar 1,846.00-€, si dhe kamatën 332.04-€, në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit prej 70% të biletës shumë prej 559.38-€, si dhe kamatën 100,17-€ që në total kapin shumë 659,55-€, në emër të ndryshimit për kompenzimin për kualifikim-licencë shumë prej 2,145.42-€, me kontributet pensionale shumë prej 107.65-€ për punëmarrësin, kontributin pensional shumë prej 107.65-€ për punëdhënësin, kamatën në shumë prej 304.83-€, të gjitha shumat e cekura më lartë të llogariten me kamatë në shkallë prej 8% duke kërkuar nga gjykata që të detyroj të paditurën që t'ua paguajë shpërblimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe specifikuar ashtu që në bazë të TOA të Kosovës për padi 104-€, për tri seanca nga 135-€, për precizim të kërkesëpadisë 104-€, për taks gjyqësore aq sa do të caktoj gjykata si dhe për përpilimin e ekspertizës financiare shumë prej 100-€.

I autorizuari i të paditurës në përgjigje në padi ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadish dhe se sipas nenit 90 pika 5 të Ligjit 03/L212 të Punës në të cilën thirret paditësi, ku thuhet se marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënësit dhe punëmarrësit të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshje të tilla kolektive e që në rastin konkret e paditura Komuna e Lipjanit si punëdhënëse e paditësit nuk është nënshkruese e kësaj marrëveshje-kontratës kolektive në të cilën është thirrur pala paditëse. Më tutje ka shtuar se

MASHT me nënshkrimin e kësaj kontrate nuk ka bërë harmozimin e saj me Ministrinë e Financave, që Komunës me qarkore buxhetore të ju lejohet ngritja e tavanit të pagave, në mënyrë që të planifikojnë edhe pagesat shtesë për stafin arsimor në kuadër të kodit ekonomik paga dhe mëditje dhe me këtë rast e paditura nuk ka mundësi financiare ti paguaj. Poashtu nëse merret parasysh Kontrata Kolektive në nenin 46 par.2 shprehimisht thotë se pagesa e tillë si për kompensimin e ushqimit bëhet brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare, e që konsideron se nuk janë plotësuar këto kushte, sepse të paditues nuk i janë ndarë mjete financiare nga institucionet nënshkruese të Kontratës Kolektive. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë ka mbajtur shqyrtimin kryesor dhe pas administrimit dhe shqyrtimit të provave, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura ndërsa nga vërtetimi mbi përvojën e punës numër 914/VI të datës 09.07.2019 nga SHFMU “Skënderbeu” Kraishtë, ku ka punuar si mësues klasë që nga data 11.11.1999, e që më vonë paditësi vazhdoi me kontratë pune në SHFMU “Drita” në fsh. Rubovc K. Lipjan si mësues klase, me marrëdhënie të punës e cila ka filluar nga dt.01.09.2015, e që vazhdon ende. Lartësia e shpërblimit jubilar, kompensimin e ushqimit, shpenzimet e transportit si dhe ndryshimin e pagës bazë të kualifikimit-licencës për paditësin, është caktuar bazuar në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, kontrata punës nr. 04-112-813/450 e datës 01.09.2015, e lidhur në mes paditësit dhe të paditurës, si dhe nga vërtetimit i përvojës së punës me nr. pro.914/VI i dt.09.07.2019 lëshuar nga SHFMU “Skënderbeu” Kraishtë, ekspertizën e ekspertit financiar Ali Gashi e dt.25.10.2021, ku mbi bazën e kontratës dhe pagës së realizuar në kohën e ushtrimit të padisë që ka realizuar paditësi dhe vërtetimeve mbi përvojën e punës i është llogaritur përqindja e pagës bazë për paditësin, dhe po ashtu në bazë të vërtetimeve që gjenden në shkresat e lëndës për paditësin të lëshuar nga shkollat përkatëse ku paditësi ka mbajtur dhe mban mësimin dhe në bazë të ditëve të angazhuara për periudhën kontestuese i është llogaritur. Gjykata e aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke e mbështet vendimin e saj në nenin 35, paragrafi 5, paragrafi 7 dhe paragrafi 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017. Për sa i përket llogaritjes së kamatë ligjore vendimin e saj e bazoi në nenin 382 të LMD-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e mori sipas nenit 452, paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë e pranon në tërësi si të rregullt dhe të ligjshëm, sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, pasi që vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, mirëpo, gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale.

Sipas Gjykatës së Apelit, nuk qëndron as pretendimi ankimor për shkelje të dispozitave të nenit 182 par.2 pika n) të LPK-së, pasi që sipas vlerësimit të kësaj gjykate, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke

qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për aprovimin e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë, andaj nuk mund të pranohet pretendimi për shkelje të tilla.

Aktgjykimi i atakuar me ankesë është i rregullt në pikëpamje të strukturës dhe përmbajtjes duke përfaqësuar kështu një vendim i cili është koherent në pikëpamje logjike dhe juridike duke eliminuar çfarëdo kontradikte për ta kualifikuar si kundërtëhënës. Mënyra e zhvillimit të procedurës dhe e hartimit të vendimit nga gjykata e shkallës së parë kanë garantuar një proces të drejtë dhe të paanshëm duke u mbështetur për përfundimin e saj në themelin faktik dhe juridik të çështjes.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore e të paditurës për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor.

Gjykata e Apelit i refuzon si të pabazuara pretendimet ankimore të palës së paditur se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk është nënshkruar nga Komuna si autoritet i veçantë dhe se nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 46 të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruerit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Gjykata e Apelit konsideron se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedhë se obligimi për përmbushjen e të drejtave të punësuarve të parapara me këtë kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura dhe në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëses, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë. Në rastin konkret është obligim i të gjitha institucionet edukativo arsimore publike dhe private të zbatojnë këtë kontratë, pasi që e njëjta është nënshkruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK-ut, prej së cilës rrjedhin detyrime të cilat është e obliguar e paditura t'i përmbush, gjegjësisht përgjegjësia për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe të drejtat tjera të cilat u përkasin punonjësve të arsimit ku sipas nenit 2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë është përcaktuar zbatimi i kësaj kontratë “1. Për të drejtat dhe obligimet që nuk janë përfshirë në këtë Kontratë, zbatohet legjislacioni në fuqi dhe Kontrata kolektive e përgjithshme. 1.1. Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK - ut. 1.2. Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT - in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo - arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

Prandaj, thëniet e të paditurës se kërkesëpadia duhet refuzuar, nga shkak se nënshkruesit e marrëveshjes nuk ia kanë siguruar të paditurit mjetet për buxhet për pagesë nuk janë të bazuara, duke marrë parasysh se ai shkak i cili do ta lironte të paditurën nga përgjegjësia, nuk është paraparë as me dispozitat e ligjit e as të Kontratës kolektive, e as përfaqësuesi i të paditurit nuk ka provuar në ndonjë mënyrë tjetër se thëniet e tij janë të bazuara.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadiës së paditësit që në emër të kompensimit të ushqimit për ditët e pranisë në punë, në emër të kompensimit shpërblimit jubilar, në emër të shpenzimeve të udhëtimit dhe në emër të licencimit t'ia kompensojë shumat e aprovuara si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjithashtu, edhe vendosja lidhur me kamatëvonesën, është në përputhje të plotë me nenin 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton detyrimin e debitorit në pagesën e kamatëvonesës si pasojë e vonesës në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit, e në rastin konkret e paditura meqë, është vonuar dhe nuk ka përmbushë detyrimin e saj ndaj kreditorit në afatin e përcaktuar me kontratë kolektive, atëherë e njëjta i detyrohet në përmbushjen e detyrimit së bashku me kamatëvonesën në shkallë prej 8% vjetore.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat nenit e 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të paditurës, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.3569/2022, datë 20.03.2025**

**Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,**  
**Ardian Ajvazi**